



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo  
Republic of Kosovo



Komuna e Istog  
Opština Istok  
Istog Municipality

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Tel: 038/200 438 14

---

KUVENDI I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY ISTOG

---

P R O C E S V E R B A L

Nga mbledhja e tridhjetë e nëntë e rregullt e Legjislacionit të VII-të të Kuvendit të Komunës së Istogut, mbajtur më: **25.06.2025**, në Sallën e Kuvendit të Komunës në Istog, filluar me punë në ora **10:00**.

Në mbledhje ishin të pranishëm këta këshilltarë:

1. Enver Rugova, LDK;
2. Hajrush Shoshi, LDK;
3. Faruk Kabashi, LDK;
4. Haki Podrimaj, LDK;
5. Ruzhdi Metaj, LDK;
6. Faik Alushaj, LDK;
7. Veton Kurtaj, LDK;
8. Arta Balaj, LDK;
9. Valbona Demaj, LDK;
10. Arianit Selmanaj, LDK;
11. Agron Gashi, AAK;
12. Negjdet Ramaj, AAK;
13. Nexhmedin Balaj, AAK;
14. Florin Dreshaj, VV;
15. Floriana Maxharraj, VV;
16. Arian Shatri, VV;
17. Andi Xhuraj, PDK;
18. Visar Haxhijaj, PDK;
19. Era Visoqi, PDK;
20. Djula Karisik, GIBI;

Mbledhja ishte e hapur dhe në mbledhje ishin të pranishëm Kryetari i komunës Ilir Ferati, NënKryetari i Komunës Ali Nimanaj Drejtorët e Drejtorive, zyrtarë administrativ si dhe media lokale RTV - Fontana ,përfaqësues të GIZI-it (lista e nënshkrimeve të evidencës së pjesëmarrjes është pjesë përbërëse e këtij procesverbali dhe e njëjta gjendet në dosje: "shembulli 1")

(Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar edhe CD-të e xhirimit gjenden në dosje: "shembulli 2").

(Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar dhe publikuar drejtpërdrejt në

<https://www.youtube.com/watch?v=Isj4tfWLGhs>

<https://www.youtube.com/watch?v=zZr1s-UIY2w>

<https://www.youtube.com/watch?v=vxj9HLQUhD4>

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z. Enver Rugova.

**Kryesuesi i Kuvendit**- përshëndeti të gjithë të pranishmit në këtë mbledhje. Hap punimet për mbledhjen e tridhjetë e tetë të rregullt të Legjislacionit të VII-të dhe për këtë mbledhje propozoi këtë rend dite:

**Konstaton Kuorumin** për mbajtjen e mbledhjes në bazë të listës së nënshkrimeve dhe prezencës në sallë, prezentë janë 20 të anëtarë të Kuvendit.

Vazhdojmë me mbledhjen :

### **R e n d d i t e**

1. Arsyetimi i mungesave në mbledhje,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Kornizes Afatmesme Buxhetore 2026-2028,
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit Ndërkomunal për Menagjimin e Integruar të Mbeturinave (PNMIM) për pesë komunat e rajonit të Dukagjinit, Pejë, Klinë, Istog, Deçan dhe Junik 2025-2035,
5. Rishqyrtimi i vendimit 00Nr.79/2025 i datës 30.04.2025 për destinimin e lokacionit për varreza të fshatit Rakosh nga prona e paluajtshme e komunës.
6. Të ndryshme.

**Kryesuesi i Kuvendit** - a ka dikush diçka? Pasi që jo, po fillojmë me rendin e ditës:

Pasi që kuorumi për mbajtjen e mbledhjes është vazhdojmë me miratimin e rendit të ditës,

Hedh në votim rendin e ditës për sot, kush është të votohet rendi i ditës me këto propozime?

**Konstatojmë** që nga 20 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 20 vota pro 0 kundër dhe 0 abstenim miratohet rendi i ditës për mbledhjen e sotme.

**Shqyrtimi i pikës 1.**

2

Procesverbali

**Kryesuesi i Kuvendit-** Në mbledhje mungon Njomza Demaj për shkaqe shëndetësore , Ajshe Metaj dhe Liridona Lajqi janë jasht vendi, Niman Beqiraj, Ardita Idrizaj, Fjolla Ukaj dhe Lavdije Bujupaj .

Të pranishëm në mbledhje janë 20 anëtarë të Kuvendit (disa prej tyre kanë lëshuar mbledhjen, disa të tjerë kanë dalë dhe kanë hyrë prapë).

### **Shqyrtimi i pikës 2.**

**Kryesuesi i Kuvendit-** e hapi debatin në lidhje me procesverbalin nga mbledhja e kaluar? A ka dikush vërejtje apo sugjerime? Pasi që nuk ka diçka tjetër e hedh në votim kush është që të miratohet procesverbali nga mbledhja e kaluar?

**Konstatojmë që nga 20 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me unanim votohet procesverbali i mbledhjes së kaluar.**

### **Shqyrtimi i pikës 3.**

**Kryesuesi i Kuvendit-** materialin e keni shkikuar, fjalën e ka drejtori Genc Ademaj.

**Drejtori për Zhvillim Ekonomik dhe Buxhet e Financa z. Genc Ademaj -** përshendet të pranishmit, bën prezantimin dhe prezanton Kornizën Afatmesme Buxhetore 2026-2028.

**Florin Dreshaj -** përshendet të pranishmit, sot na keni sjellë tabelen në shikim të parë duken se janë të detajuara por kur e bejmë një analizë të thjeshtë shumica e projekteve nuk janë të specifikuara, ka plot projekte që janë me investime të pa sigurta. P.sh ndertimi i urave në komunë e Istogut nga burimet tjera ku ky burim nuk është i sigurt dhe nuk janë specifiku cilat ura, trasimi i rrugëve as këto nuk janë specifikuar dhe as nuk kanë burim të sigurta të mjeteve buxhetore këto mos të paragjykoj por kanë me mbetur vetem në letër. Ndërtimi i ndriqimit në Vrellë ose në Cerrcë nuk është specifikuar në cilat lagje. I përmenda disa raste me burime të financimit të pa sigurta, disa rrugë në Cerrcë janë të cekura dy herë Rr. "Maxharraj" ka shumë gabime. Për me pas mundësi LVV me votu këtë plan pro duhet të jetë me transparent edhe me ne edhe me qytetarët.

**Floriana Maxharraj -** përshendet të pranishmit, në kete listë kisha propozuar që edhe në fakt nuk ish dashtë të mungoj wc publike edhe nese financimi bëhet nga burimet tjera të financimit ashtu si janë edhe disa projekte të mëdha, është projekt shumë i rëndësishem dhe i domosdoshëm për qytetarët në komunën tonë. Një tjetër nevojë urgjente janë rrethojat gjatë lumit në rrugën "Nënë Tereza" nga rrethi deri të Express Store, kjo rrugë është e frekuentuar nga qytetarët është e rrezikshme për fëmijët. I kam edhe disa kërkesa nga disa banorë ku këtu

rrugët, ndriçimi dhe trotuarët janë të specifikuara me fshatra unë po i thom si kërkesa,

Ndërtimi i trotuarit në Rr. "Milazim Mavraj" nga varrezat të lagja "Mavraj" deri të lagja "Qetaj" në Trubuhoc.

Ndriçimi Publik për lagjen "Mahaj" të përfshihet e gjith lagja.

Një kanal të ujitjes në fshatin Dubovë nga brana deri të lagja "Mahaj" ku gjatësisa sipas banorëve është 600m, ky kanal do të mundësonte ujitjen e diku mbi 15 mijë hektarë tokë bujqësore.

**Dula Karišik** - përshendet të pranishmit, siç e dini Kuvendi i Komunës ka dy komitete obligative KPF-në dhe Komitetin për Komitete, jam Kryesuese për Komitetin për Komunitete të gjitha propozimet dhe vendimet që i merr ekzekutivi diskutohen në atë komitete po ashtu është edhe detyrë e komitetit të marrë pjesë në projektet e buxhetit, ne dje jemi informuar por projektet buxhetore propozimet që ne i kemi marrë:

Asfaltimi i rruges "Sllatin Lla" në Dobrushë

Asfaltimi i rruges "Bihorska"

Asfaltimi i rruges "Alia Izet Begoviq"

Ndriçimi i rruges dhe trotuari nga Istogu në Dobrushë,

Ndriçimi i rruges dhe trotuari në Llukaç

Asfaltimi i rruges "Gradina" në Cerkolez

Asfaltimi i rruges në Serbobran dhe Osojan.

Kanalizimi nga shkolla në Dobrushë

Asfaltimi i rruges "Sveqanska"

Ndërtimi i parkut të fëmijëve në shkolla fillore në Dobrushë, parku ekzistues që disa vite nuk po mirëmbahet dhe nuk ka lodra për fëmijë.

Këto propozime çka ne i kemi paraqitur janë të rëndësishme për të gjithë qytetarët posaqërisht për komunitetin pakicë të gjitha këto kërkesa do të paraqes edhe me shkrim ekzekutivit. Shpresoj që ju do të bëni të pamundshëm që ti realizoni të gjitha këto projekte të propozuara nga Komiteti për Komunitete.

**Drejtori për Zhvillim Ekonomik dhe Buxhet e Financa z. Genc Ademaj** - sqaron rreth pyetjeve dhe kërkesave të anëtareve të Kuvendit.

**Agron Gashi** - përshendet të pranishmit, i kam disa propozime :

Nga banorët e fshatit Prigodë kam dy propozime për dy projekte

Ndriçimi i publik në fshatin Prigodë si dhe

Ndërtimi i kanalit të ujitjes, aty ka filluar një kanal por është një pjesë e vogël të shkolla, niset kanali të pjesa e Sadikajve dhe perfundon tek lagja "Dekaj".

Projekti tjetër është nga banorët e qendrës së Istogut ku kërkojnë shtimin e kapaciteteve në parkun e qytetit sepse tash me ardhjen e qytetarëve parku po është shumë i kërkuar, kërkohet të shtohen ulëset për pushim si dhe aktivitete tjera siç janë lodrat për fëmijë.

Nderhyrja e renovimit tek banesat kolektive e kam bërë këtë kërkesë edhe me herët, kjo paraqet rrezik të madh akoma për qytetarët e Istogut.

**Negjdet Ramaj** - përshendet të pranishmit; kam disa propozime pas konsultimeve me isa qytetar nga zona nga unë vi:

Ndertimi i një pende mbi fshatin Uçë për qëllime të ujitjes dhe amvisërisë, kjo mund të jetë nga burime tjera të financimit.

Fillimi i procedurave në vitin 2026 Rruga Vujdull – Moken hapja e traseve të rruges pasi që rruga egzistuese është bajagi e rrezikshme për banoret.

Rregullimi i mejtepit në fshatin Uçë, ku ka shërbyer edhe për edukimin e brezave është në gjendje të mjerueshme (besoj që është monument i mbrojtur) me fut si projekt sepse ka kërkesa të banorëve është të xhamia.

Hapja dhe mbushja e rruges “Ramë Alia” lagja Ramaj dhe Muzliaj prej varrezave ajo rrugë me shumë shërben për punimin e tokave bujqësore.

Hapja e një shtegu për mjetet motorike, ku për keto mjete do të ishte pikë referuese që të mos i demtojnë pronat publike.

**Drejtori për Zhvillim Ekonomik dhe Buxhet e Financa z. Genc Ademaj** - sqaron rreth propozimeve.

**Veton Kurti** - përshendet të pranishmit, kam një kërkesë nga një banor i lagjes ku edhe unë banoj është një hapsirë publike aty e pa shfrytëzuar te vega kërkesa është me ndertuar një shtëpi fshati për nevoja të banorëve aty.

**Drejtori për Zhvillim Ekonomik dhe Buxhet e Financa z. Genc Ademaj** - sqaron rreth kërkeses.

**Arta Balaj** - përshendet të pranishmit, dje në Komitetin për Komunitete e kam berë një propozim që kryesuesja nuk e ceku ketu:

Propozoj Ndertimin e trotuarit dhe ndriqimit public në rr. “Mustar Blakaj” në Istog të Poshtem e deri të “Tuzi” në fshatin Dobrush, kjo rrugë kalo përmes fshatrave Istog i Poshtëm, Muzhevina, Lluga, Llukafci i Begut dhe Dobrushë zona të banuara nga të gjitha komunitetet, është rrugë me një rëndësi të madhe.

**Dula Karišik** - e kanë keqkuptuar sepse është përmendur por nuk është dal mirë te perkthimi.

**Andi Gjuraraj** - përshendet të pranishmit, e kam një propozim jam duke e pasur që tri vite kete propozim:

Propozoj që të behet rregullimi i pllatos të kompleksi banesor që është përballë “Kekut” është kërkesë e banorëve dhe kishë qenë shumë me vend që me u rregulluar ajo pjesë sa ma shpejt.

**Drejtori për Zhvillim Ekonomik dhe Buxhet e Financa z. Genc Ademaj** - sqaron rreth kërkesës.

**Negjdet Ramaj** - kam një kërkesë nga një qytetar i fshatit Kaliqan lagjia Cakutaj janë 12-13 shtëpi ankohen që nuk kanë ujë për pije dhe as për higjenë, të hynë në

buxhet për mbledhjen e disa krojeve aty sepse mbi fshat paska disa kroje mundësisht që vitin e ardhshëm me siguru ujë të paktën për higjenë.

**Drejtori për Zhvillim Ekonomik dhe Buxhet e Financa z. Genc Ademaj** - sqaron rreth kërkeses.

**Hajrush Shoshi** - përshendet të pranishmit, qeshtja e investimeve në arsim po me duket shumë e vogel. Nuk janë askund investimet në digjitalizimin e klasve. Ka shumë projekte që ka nevoj për arsim.

Kerkoj që arsimi të ndihmohe sepse edhe statistikat e fundit se për shka të kushteve dhe kriterëve numri i nxense ka ra. Dhe shkollat private numri i nxensve po rritet për ditë. Është mire te krijojmi kushte.

**Andi Xhuraj**- nje pyetje te përkrahja e rinisë. Ndërtimi i fushës ndihmëse në Istog, pata qejf me ditë ku është? Ku ka me u bërë?

**Drejtori për Zhvillim Ekonomik dhe Buxhet e Financa z. Genc Ademaj** -ka të bëj me pjesën e ndërtimit të zhveshtoreve, infrastrukturës përcjellëse te fusha që është e ndërtuar në Istog te palestra e sportit. Eshtë projekt në vazhdimësi dhe si të tillë duhet me e lënë.

**Kryesuesi i Kuvendit**-fjalën e ka Floriana Maxharraj.

**Floriana Maxharraj**- në buxhetin e vitit të kaluar, te grantet dhe subvencionet, ka qenë i paraparë edhe subvencionimi i nënave lehona, tani ju kanë mbetur edhe tre muaj qeverisje, a mundeni me na treguar kur ka me u bërë.

**Genc Ademaj**- e saktë ajo qe po e thua, jemi duke e plotësuar dhe ndryshuar Rregulloren e Subvencioneve qe e ka kaluar pjesën e dëgjimit publik dhe mbledhjen e ardhshme kemi me e pasur në Kuvend për miratim. Buxheti është ndare vjet, te pjesa financiare për subvencionimin e nënave lehona nuk është asnjë problem.

**Kryesuesi i Kuvendit**- fjalën e ka Faik Alushaj.

**Faik Alushaj**- drejtorit një pyetje, këto propozimet që janë bërë për projekte kapitale për 2026-2028 në rrugën "Dëshmorët Dervishaj" lagjen ku jetoj unë, nuk po e shoh askund që ka ndonjë projekt as për kanalizim as për trotuar.

**Drejtori për Zhvillim Ekonomik dhe Buxhet e Financa z. Genc Ademaj** po shfrytëzoi rastin me ju njoftuar për një projekt të madh që është zgjerimi i rrugës ekzistuese Istog-Peje-Deçan-Junik-Gjakovë dhe lidhet me rrugën e Kombit në Prizren. Projekti është bërë, te pjesa e Off-On-it ndërtohet rrethrotullimi, ne si komunë çka kemi arritur të përfitojmë prej kësaj është edhe ndërtimi i transitit që është nga pjesa e rrugës ku jeton ti e deri te "Nora Market" projekti kryesor është bërë është dorëzuar në ministrinë e Infrastrukturës, ajo pjesë te ju është pjesë e

shpronësuar dhe nuk ka kosto shtesë për shpronësim, ndërsa pjesa e transitit, është në proces vlerësimi për shpronësim nga ministria. Vazhdon sqarimin.

**Kryesuesi i Kuvendit-** është shtjerrë komplet diskutimi. Ju falënderoj për propozimet e juaja. Po hedh në votim KABK me të gjitha propozimet që u dhanë këtu si dhe propozimet e KPF-së dhe propozimet e Degjimit Publik që është mbajtur me qytetarë, të hynë në KABK ?

**Konstatohet që nga 19 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 16 vota për, 3 kundër dhe 0 abstenime miratohet Kornizë Afatmesme Buxhetore 2026-2028.**

**Shqyrtimi i pikës 4.**

**Kryesuesi i Kuvendit-** po e hedh në votim, kush është të miratohet ky Plan?

**Konstatohet që nga 18 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 18 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenim miratohet Plani Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturisë (PNMIM) për pesë komunat e rajonit të Dukagjinit, Pejë, Klinë, Istog, Deçan dhe Junik 2025-2035.**

**Shqyrtimi i pikës 5.**

**Kryesuesi i Kuvendit-** jep sqarime të nevojshme lidhur me këtë pikë. E hap debatin, fjalën e ka Florin Dreshaj.

**Florin Dreshaj-** nuk është hera e parë që po na kthejnë, po thua për çështje banale por po dua ta di cila është çështja banale që po i kthen ministria këto vendime.

**Kryesuesi i Kuvendit-** po e them ashtu se e kam fjalën për gabime të vogla që bëhen, se ka pasur raste për vendime që teknikisht kane shkuar gabim, na ka kanë thirr dhe është rregulluar. E hedh në votim, kush është për?

**Konstatohet që nga 18 anëtarë të Kuvendit të pranishëm 18 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenim miratohet Rishqyrtimi i vendimit 00 Nr.79/2025 i datës 30.04.2025 për destinimin e lokacionit për varreza të fshatit Rakosh nga prona e paluajtshme e komunës.**

**Shqyrtimi i pikës 6.**

**Kryesuesi i Kuvendit-** fjalën e ka Negjdet Ramaj.

**Negjdet Ramaj-** një pyetje për drejtorin Agon Dreshaj, në lidhje me parcelën që votuam mbledhjen e kaluar për varreza, e dëgjova debatin që ishte me qytetarë, e pashë një banor të asaj lagje që e ka bërë kërkesën e parë prej 90 ari, desha ta di

psë po bëhet ajo neglizhencë e nuk po vendosen pikat e parcelës parë prej 90 ari pasi që ai banor më ka treguar që ka qenë në komunë dhe është mirë me ja dhënë një përgjigje direkte e jo me e shëtitur prej një drejtori te një tjetër.

**Kryesuesi i Kuvendit-** drejtori e ka fjalën.

**Agon Dreshaj-** jam takuar me banorin e Zhakovës ka qenë në zyrë për me dalë me gjeometer për me i vendos pikat e parcelës që e kemi votuar. Por ne e kemi votuar tani edhe një parcelë tjetër, dhe ideja ka qenë që me i vendos pikat te të dyja në terren. Ne kufinjtë e parcelës dalim me gjeometer i caktojmë, por merr një periudhë kohore deri te zhvillimi i projektit, dhe secili operator që shkon me punuar aty kërkon prej nesh prapë me i vendosur pikat, dhe kam kërkuar nga pala që me diskutuar me drejtorinë për Shërbime Publike a kemi projekt për me dalë me e përgatit vendin për varreza që mos ti dërgojmë gjeometrat dy herë për të njejtën punë. Prapë ka insistuar me i vendos pikat, dhe i kemi premtuar që brenda javës do kryhet.

**Kryesuesi i Kuvendit-** fjalën e ka Negjdet Ramaj.

**Negjdet Ramaj-** desha ti tregoj edhe Agonit edhe të gjithëve që a u bindet dje gjatë dëgjimit publik që ajo parcelë që e ndan prej 20 ari që e ka kërkuar dikush prapë për varreza, banori i po asaj lagje deklaroi që atë parcelë duam ta kërkojmë për një shtëpi të fshatit. Këtu është një keqkuptim, duhet me i pastruar gjërat e kur të votojmë dicka të dimë se cka po votojmë. Po mendoj që nuk është e paqëllimshme kjo cka po ndodhë. A jeni bindur që kemi pasur të drejtë atë ditë kur kemi diskutuar për këtë temë.

**Kryesuesi i Kuvendit-** sa munda me e kuptuar qytetarin dje, ai ka kërkuar vetëm ad-hoc tokën për me u ndërtuar shtëpia e fshatit, nuk ka kërkuar vendin.

**Agon Dreshaj-** unë nuk e di çfarë mendojnë banorët, ju kam treguar dhe kam qenë shumë transparent. 35 nënshkrime i kam, kërkesa është destinim për varreza, 20 ari. Nëse dikush ka mbledhur nënshkrime duke mos treguar për çfarë do e bëj kërkesën, nuk është përgjegjësi e imja.

**Negjdet Ramaj-** me e marrë pak logjikisht 20 ari nuk kërkohen për varreza, kur i kemi të destinuara 90 ari. E kam edhe një pyetje për drejtorin e Zhvillimit Ekonomik. Deklaroi që e kanë bërë pranim dorëzimin e projektit austriak për fshatrat e mbi vadës për ujësjellësin dhe tani është kompetencë e Hidrodrinit. Desha ta di kur është bërë pranim dorëzimi dhe si ka mundur të bëhet pa shkuar uji në fshatin Cerkolez, Padalishtë, Kërrninë, Veriq, në këto fshatra nuk ju ka shkuar uji dhe Genci e di që bazeni mbi fshatin Cerkolez nuk i plotëson kushtet teknikisht pasi që rrjedh uji, ai para se të lëshohet në përdorim ka nevojë për renovim.

Drejtori për Zhvillim Ekonomik dhe Buxhet e Financa z. Genc Ademaj -ne po flasim për rrjetin primar e jo sekondar. Përkundrazi që komuna e ka financuar edhe rrjetin sekondar. Dje e kemi pasur në takim kryeshefin e Hidrodrinit ata nuk kanë pranuar me i bërë lidhjet e daljeve sekondare pa u furnizuar banorët me ujemates kjo është arsyeja pse ata sot nuk janë të lidhur. E kanë bërë një specifikim që lidhjet ka me i kryer Hidrodrini dhe ka me qenë një thirrje publike për qytetarët javën e ardhshme që me ardh me i bërë kërkesat te zyret e Hidrodrinit për shkak të menaxhimit. Ka keqpërdorim të madh të ujit kjo është faktike. Vazhdon sqarimin.

Kryesuesi i Kuvendit- e shpallë të mbyllur mbledhjen e sotme.  
Falënderon të gjithë për durimin qe patën, dhe kontributin e dhënë,  
Faleminderit për pjesëmarrje, mirupafshim në mbledhjet e tjera.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 13:00

Procesmbajtëse,  
Vjosa Hysenaj



Kryesues i mbledhjes,  
Enver Rugova

